



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

Data 16.06.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: : “Shpenzime per rritjen e AQ licensa dhe sherbime (Sherbime dhe software) i ndarë sipas loteve:

Loti 1: “Licenca software”

Loti 2: “Shërbime API Servers”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Shërbimet e teknologjisë së informacionit, 72222300-0

Shërbimet e lidhura me softwaret, 72260000-5

Shërbimet e implementimit të softwareve, 72263000-6

Shërbimet e furnizimit të softwareve; 72268000-1

VLERA E FONDIT LIMIT: 3,776,000 (tre milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë pa tvsh i ndarë sipas loteve:

Loti 1: “Licenca software” = 2 976 000 (dy million e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lek, pa tvsh.

Loti 2: “Shërbime API Servers” = 800 000 (tetëqind mijë) lek, pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Korce** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Loti 1 – “Licenca software”

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023,2024,2025**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës të fondit limit të lotit që prokurohet.

Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku në të kundërt do të skualifikohet në të gjitha lotet ku merr pjesë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenet 43 pika 2c dhe pika 3, neni 55 pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros të jete jo më e vogël se 40 % të vlerës së perlogaritur të kontrates që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2c dhe nenin 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ligjin nr. 29/2023 Për Tatimin mbi të Ardhurat, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

*AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje Nenin 61 të ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”: 1. Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. **Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.***

2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së fondit limit të lotit që prokurohet.

Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet teknike sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku në të kundërt do të skualifikohet në të gjitha lotet ku merr pjesë.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

-Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë gjithashtu edhe Kontraten e Bashkimit të operatoreve ekonomikë.

-Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë gjithashtu edhe Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor si dhe Miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së perlllogaritur të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **autorizim prodhuesi ose autorizim distributori** për zerat e produkteve software sipas tabelës së mëposhtme. Në rast se do të paraqitet autorizim distributori duhet të provohet dhe lidhja midis prodhuesit dhe distributorit, nëpërmjet kontratës ose dokumentit të angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit. Secili nga dokumentat duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave si dhe origjinale ose fotokopje të noterizuara.

Tabela me zerat e produkteve software per te cilat duhet te paraqiten autorizim prodhuesi ose autorizim distributori:

1.	Antivirus I qenderzuar 1 vit 100 users EDR/XDR
----	--

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; pika 6, e nenit 41, të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar ku është e cituar: 6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, si dhe duke iu referuar per analogji vendimeve te KPP-se dhe rekomandimeve te APP-se, Autoriteti Kontraktor ka gjykuar qe te paraqitet autorizim prodhuesi ose autorizim distributori per disa zëra objekt prokurimi.

Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon kanalën zyrtar të origjinës së produkteve software specifike që kërkohen në këtë prokurim, i garanton gjithashtu AK se ofertuesi është i autorizuar edhe nga pikëpamja territoriale (pra për Shqipërinë) për ofrimin tek AK të këtyre produkteve. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të produkteve që kërkohen të blihen e që janë prodhuar/krijuar sipas standardeve më të larta nga prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë shitëse dhe teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës, duke vërtetuar se disponojnë autorizimet përkatëse për furnizimin e produkteve software, objekt i kontratës, të lëshuara nga prodhuesit/distributorët përkatës si dhe që do vijojnë për të zbatuar kushtet e garancisë.

Kërkesa për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose të distributorit është vendosur vetëm për produktin “Antivirus i qendëruar 1 vit 100 users EDR/XDR”, pasi ky produkt përbën një komponent kritik të sigurisë kibernetike të infrastrukturës së institucionit dhe do të përdoret për mbrojtjen e sistemeve, rrjetit dhe të dhënave institucionale nga kërcënimet kibernetike.

Paraqitja e autorizimit synon të garantojë se operatori ekonomik është i autorizuar zyrtarisht nga prodhuesi ose distributori për furnizimin, aktivizimin, mbështetjen dhe mirëmbajtjen e licencave përkatëse, duke siguruar origjinalitetin e produktit, vlefshmërinë e licencave, aksesin në përditësime, si dhe mbështetjen teknike nga kanalet zyrtare.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me standardet:

- ISO 9001, ose ekuivalente, Për sistemin e menaxhimit të cilësisë
- ISO 27001, ose ekuivalente, Për Sigurinë e Informacionit

Çertifikata duhet të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

* Termi "ekuivalent" përfshin edhe standartet SSH (nese disponohen) te adoptura nga DPA mbi bazen e atyre nderkombetare.

* Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

* Në rast se dokumentet e mesipërme janë në gjuhë të huaj ato duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Argumentimi: Kërkesa e mesipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Përmbushja e standardit ISO 9001 ose ekuivalent është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e cilësisë së produkteve software që parashikon kontrata. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standardeve të cilësisë.

Përmbushja e standardit ISO 27001 ose ekuivalent është thelbësore sepse krijon një kornizë të provuar ndërkombëtarisht për menaxhimin e cilësisë dhe mbrojtjen e të dhënave, duke ulur rrezikun juridik, operativ dhe reputacional.

Loti 2 - "Shërbime API Servers"

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mesipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023,2024,2025**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës të fondit limit te lotit që prokurohet.

Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku në të kundërt do të skualifikohet në të gjitha lotet ku merr pjesë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenet 43 pika 2c dhe pika 3, neni 55 pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i sherben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros te jete jo më e vogel se 40 % të vlerës së perlllogaritur te kontrates qe prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2c dhe nenin 55 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne nenin 43 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ligjin nr. 29/2023 Për Tatimin mbi të Ardhurat, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

*AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje Nenin 61 të ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”: 1. Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. **Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.***

2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes te njoftimit te kontrates, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së fondit limit të lotit që prokurohet.

Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet teknike sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku në të kundërt do të skualifikohet në të gjitha lotet ku merr pjesë.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- c) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe te deklaruara ne organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

d) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

-Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë gjithashtu edhe Kontraten e Bashkimit te operatoreve ekonomikë.

-Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë gjithashtu edhe Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor si dhe Miratimin zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së perlllogaritur te kontrates qe prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me standardet:

- ISO 9001, ose ekuivalente, Për sistemin e menaxhimit të cilësisë
- ISO 27001, ose ekuivalente, Për Sigurinë e Informacionit

Çertifikata duhet të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

* Termi "ekuivalent" përfshin edhe standartet SSH (nese disponohen) te adoptura nga DPA mbi bazen e atyre nderkombetare.

* Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

* Ne rast se dokumentet e mesiperme jane në gjuhë të huaj ato duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Përmbushja e standardit ISO 9001 ose ekuivalent është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e cilësisë së produkteve software që parashikon kontrata. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se

Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standardeve të cilësisë. Përmbushja e standardit ISO 27001 ose ekuivalent është thelbësore sepse krijon një kornizë të provuar ndërkombëtarisht për menaxhimin e cilësisë dhe mbrojtjen e të dhënave, duke ulur rrezikun juridik, operativ dhe reputacional.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Fondi limit, sasite, termat e references, specifikimet teknike dhe kriteret e vecanta të pranimit janë hartuar nga specialist i fushës në zbatim të urdherit Nr 169 date 20.02.2026 sipas procesverbalit të mbajtur prej tij.

Specifikimet teknike të produkteve software objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja funksionale dhe teknologjike të institucionit për rritjen e sigurisë, efikasitetit operacional dhe kapaciteteve digjitale në përmbushjen e detyrave institucionale. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Në respektim të nenit 36 të LPP-së në të gjitha rastet kur përmendet “markë” pranohet termi “ose ekuivalent i tij/i saj”.

Për Lotin 1 – Licenca Software, nevoja lidhet me:

- garantimin e sigurisë kibernetike të infrastrukturës së teknologjisë së informacionit përmes zgjidhjeve antivirus, EDR/XDR dhe filtrimit DNS;
- administrimin dhe mbështetjen në distancë të pajisjeve dhe sistemeve informatike;
- përdorimin e platformave moderne të inteligjencës artificiale për përmirësimin e produktivitetit të stafit, analizimin e informacionit, hartimin e dokumenteve, përkthimin dhe automatizimin e detyrave rutinë;
- automatizimin e proceseve të punës, komunikimit institucional dhe aktiviteteve informuese;
- krijimin dhe përpunimin e materialeve multimediale për nevoja institucionale;
- sigurimin e licencave dhe shërbimeve të nevojshme për funksionimin e pandërprerë të sistemeve informatike.

Për Lotin 2 – Shërbim API për Platformë të Inteligjencës Artificiale Gjenerative, nevoja lidhet me:

- integrimin e funksionaliteteve të inteligjencës artificiale në sistemet dhe aplikacionet ekzistuese të institucionit;
- automatizimin e proceseve të përpunimit të dokumenteve, analizës së të dhënave dhe ofrimit të asistencës digjitale;
- zhvillimin e shërbimeve elektronike dhe aplikacioneve që kërkojnë përpunim inteligjent të informacionit;
- rritjen e efikasitetit në menaxhimin e volumeve të mëdha të dokumenteve dhe të dhënave;
- përdorimin e teknologjive moderne cloud pa nevojën e investimeve shtesë në infrastrukturë fizike dhe kapacitete serverike lokale.

Këto shërbime konsiderohen të domosdoshme për modernizimin e proceseve të punës, forcimin e sigurisë së informacionit dhe mbështetjen e transformimit digjital të institucionit.

Për Licencat software:

Qëllimi i kontratës është furnizimi me licenca software, shërbime cloud dhe platforma teknologjike të nevojshme për garantimin e sigurisë kibernetike, administrimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit, automatizimin e proceseve të punës, menaxhimin në distancë të sistemeve, filtrimin dhe mbrojtjen e trafikut të rrjetit, si dhe përdorimin e teknologjive të inteligjencës artificiale në funksion të rritjes së eficiencës institucionale.

Nëpërmjet kësaj kontrate synohet forcimi i mbrojtjes së rrjeteve dhe pajisjeve fundore, sigurimi i vazhdimësisë operacionale të sistemeve ekzistuese, përmirësimi i kapaciteteve të monitorimit dhe reagimit ndaj incidenteve të sigurisë, automatizimi i proceseve teknike dhe administrative, si dhe përdorimi i platformave moderne të inteligjencës artificiale dhe shërbimeve cloud për mbështetjen e veprimtarisë së përditshme të institucionit.

Kontrata përfshin licenca dhe shërbime për sigurinë e rrjetit dhe endpoint-eve, menaxhimin dhe suportin në distancë, filtrimin e trafikut DNS, automatizimin e proceseve dhe integriteteve teknologjike, si dhe përdorimin e platformave të inteligjencës artificiale dhe gjenerimit të përmbajtjes digjitale, në përputhje me nevojat operative të Bashkisë Korçë.

Përshkrimi i lotit:

Furnizim me licenca software dhe abonime vjetore/shumëvjeçare për:

- mbrojtje antivirus dhe EDR/XDR;
- sisteme operative dhe platforma të produktivitetit;
- menaxhim dhe mbështetje në distancë të pajisjeve dhe përdoruesve;
- platforma të inteligjencës artificiale (AI) për asistencë, gjenerim përmbajtjeje dhe analiza;
- modele dhe platforma për gjenerimin dhe editimin e videove me inteligjencë artificiale;
- automatizimin e komunikimit, marketingut dhe proceseve të punës (workflow automation);
- shërbime të filtrimit dhe sigurisë DNS në cloud;
- shërbime të tjera të ngjashme software sipas specifikimeve teknike.
-

Për API Servers:

Përshkrimi i lotit:

Furnizim me shërbim API cloud për përdorimin e modeleve të inteligjencës artificiale gjenerative, me pagesë sipas konsumit, për integrimin me aplikacionet dhe sistemet e institucionit. Shërbimi do të përdoret për përpunim teksti, analizë dokumentesh, përmbledhje, përkthim, klasifikim informacioni, automatizim procesesh, asistencë teknike dhe funksione të tjera të avancuara të përpunimit inteligjent të të dhënave, pa nevojën e instalimit të infrastrukturës fizike nga Autoriteti Kontraktor.

NJËSIA E PROKURIMIT